

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR**  
**“\_VOIS ALBANIA” SHPK**

**PRONËSIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA**

**Neni 1**  
**Ortaku i Vetëm**

1.1. Shoqëria “\_VOIS Albania” SHPK (“Shoqëria”) është krijuar në datën e parashikuar në vijim nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

**Vodafone International Holdings B.V**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Rotterdam, Hollandë, në adresën si vijon: Rivium Quadrant 173, 2909 LC Capelle aan den IJssel, regjistruar në regjistrin tregtar Holandez me nr. 24235177 (më poshtë referuar si “**Ortaku i Vetëm**”).

**Neni 2**  
**Emri**

2.1. Emri i Shoqërisë është “\_VOIS Albania” SHPK.

2.2. Emri tregtar i Shoqërisë do të jetë “\_VOIS”).

**Neni 3**  
**Forma ligjore**

3.1. Shoqëria do të ketë formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3.2. Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore në përputhje me parashikimet e ligjit shqiptar.

**Neni 4**  
**Baza ligjore**

4.1. Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”) si dhe parashikime të tjera të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

#### Neni 6

#### Selia / Adresa e regjistruar e Shoqërisë

- 6.1. Selia e parë e Shoqërisë është në adresën si vijon: Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, Kati i 5, Hyrja 2, Tiranë, Shqipëri.
- 6.2. Administratori/ët gëzojnë të drejtën për të hapur ose mbyllur adresa sekondare të Shoqërisë në Shqipëri.
- 6.3. Ortaku i Vetëm mund të themelojë apo mbyllë: agjensi, zyra përfaqësimi, degë të cilat nuk kanë natyrë dytësore, si dhe të vendosë për ndryshimin e selisë.

#### Neni 7

#### Objekti

- 7.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në ofrimin e shërbimeve mbështetëse të biznesit për palë të treta, përfshirë por pa u kufizuar në: aktivitete *Call Center*; aktivitete edituese lojrash kompjuterike; publikimit të programeve të tjera *software*; aktivitete për zhvillimin e programeve të personalizuar *software* (programe *software* të orjentuar nga nevojat e konsumatorit); aktivitete konsulence të teknologjisë së informacionit; aktivitete menaxhimi (menaxhim dhe operim) i paisjeve informatike; aktivitete të tjera shërbimi të teknologjisë së informacionit; përpunimin e të dhënave, administrimin e faqeve të internetit dhe aktivitete të tjera të lidhura me to; aktivitete të portaleve në internet; dhënien me qera dhe operimin e pasurive vetjake ose atyre të marra me qera; studim i tregut dhe anketime lidhur me opinionin publik; aktivitete të tjera konsulence biznesi dhe manaxheriale; organizimin e konventave dhe panairove; aktivitete mbështetëse edukative; aktivitete të burimeve njerëzore dhe zyrave qëndrore; aktivitete të përkohshme të agjensive të punësimit si dhe cdo aktivitet tjetër lidhur me sa më sipër përfshirë ofrimin e shërbimeve.
- 7.2. Me qëllim përmbushjen e objektit të mësipërm, Shoqëria ka të drejtë:
  - a. Të lidhë çfardo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë, ente private ose publike, Shoqëri, shtetin dhe organizata Shqiptare apo të huaja;
  - b. Të themelojë të gjithë llojet e shoqërive ose të marrë pjesë në shoqëri shqiptare ose të huaja apo në bashkime shoqërish/*joint ventures* ose lloje të ndryshme biznesesh që kanë objekt të njejtë ose të ngjashëm me atë të Shoqërisë;
  - c. Të themelojë degë ose agjensi në Shqipëri ose jashtë territorit shqiptar;
  - d. Të përfaqësojë biznese shqiptare ose të huaja të lidhura me qëllimin e Shoqërisë;
  - e. Të marrë hua, të pranojë garanci personale ose të një lloji tjetër, të marrë përsipër detyrime, të lëshojë instrumente financiare të maturuara ose të maturueshme (*drafts* ose *bills of exchange*), ceqe, obligacione ose garanci financiare apo tituj të tjerë për llogari të Shoqërisë dhe të lëshojë garanci të tjera kolaterale.

f. Të ndërmarrë cfardo aktiviteti të lidhur, tregtar ose të një lloji tjetër dhe të procedojë me cdo veprim ligjor ose transaksion, drejtpërdrejt ose indirekt të lidhur me qëllimin e Shoqërisë, ose që kontribuon drejtpërdrejt ose indirekt në përmbushjen e qëllimit të Shoqërisë.

7.3. Shoqëria mund të realizojë në mënyre plotësuese, dhe rrjedhimisht në mënyrë rastësore dhe jo direkte, dhe në cdo rast vetëm me qëllim përmbushjen e qëllimit të biznesit të Shoqërisë, cfardo transaksioni apo aktiviteti tregtar, industrial apo financiar në lidhje me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që mund të konsiderohen të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektit të korporatës.

7.4. Shoqëria mund të performojë operacione/ veprime të tjera ndihmëse ose të lidhura, si dhe të gjithë aktivitetet e nevojshme ose të duhura me qëllim përmbushjen e qëllimit të biznesit në përputhje me ligjin.

7.5. Objekti i Shoqërisë mund të modifikohet ose ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

### **Neni 8 Kapitali**

8.1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë në datën e hartimit të këtij statuti do të jetë 10.000 EURO dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 10.000 EURO (dhjetëmijë euro).

8.2. Kapitali do të shlyhet në cash dhe do të derdhet në llogarinë bankare të Shoqërisë të hapur pranë çfarëdo banke në Shqipëri, brenda 60 ditësh kalendarike nga data e regjistrimit.

8.3. Ortaku i Vetëm zotëron 100% të kapitalit.

### **Neni 9 Transferimi i kapitalit/Kufizime për transferimin**

9.1. Ortaku i Vetëm është zotëruesi i vetëm i të gjitha kuotave të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

9.2. Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, tek palë të treta vetëm përmes një akti të shkruar.

9.3. Kuotat e kapitalit të regjistruar transferohen me trashëgimi pa ndonjë akt të veçantë.

### **Neni 10 Zmadhimi i Kapitalit**

10.1. Ortaku i Vetëm mund të zmadhojë kontributin e tij në kuotën e kapitalit të regjistruar.

10.2. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet gjithëashtu me nënshkrimin dhe pagimin e kuotave të reja nga ortakët të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 11**  
**Zvogëlimi i kapitalit**

11.1. Në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të kryhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar.

**STRUKTURA DREJTUESE**

**Neni 12**  
**Vendimet e Ortakut të Vetëm**

- 12.1. Vendimet kryesore në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë merren me vendim të Ortakut të Vetëm, i cili është organi më i lartë i Shoqërisë që gëzon të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen. Për aq kohë sa ekziston vetëm një Ortak i Vetëm në Shoqëri vendimet e Ortakut të Vetëm do të merren në formën e një dokumenti të vetëm të shkruar dhe nuk do të mbahet procesverbal.
- 12.2. Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ekzekutohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga përfaqësuesi i autorizuar nga Ortaku i Vetëm.
- 12.3. Vetëm Ortaku i Vetëm ka të drejtë të vendosë për çështjet si më poshtë:
- a) modifikimin dhe ndryshimin e Statutit;
  - b) pranimin e ortakëve të rinj (pas një rritje të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose transferimit të kuotave)
  - c) rritjen dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  - d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo formë tjetër transformimi të Shoqërisë;
  - e) të vendosë për blerjen dhe/ose heqjen dorë/dorëzimin e interesave pjesëmarrëse në Shoqëri, në Shqipëri ose jashtë;
  - f) të themelojë dhe/ose mbyllë degë apo zyra përfaqësimi;
  - g) të miratojë bilanci vjetor dhe pasqyrat financiare, të përcaktojë buxhetin vjetor dhe të miratojë ndarjen e fitimit dhe/ose mbulimin e humbjeve;
  - h) të zgjedhë dhe shkarkojë nga detyra administratorët;
  - i) të vendosë lidhur me masat për ekzaminimin dhe kontrollin e mënyrës së realizimit të operacioneve të Shoqërisë;
  - j) të vendosë për rregullat e menaxhimit të brendshëm;
  - k) të ngrejë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
  - l) të vendosë për blerjen, shitjen ose barrësimin e pasurive reale ose të paluajtshme të Shoqërisë;
  - m) të vendosë për prishjen e Shoqërisë;
  - n) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
  - o) të vendosë për emërimin e auditorëve;
  - p) të përcaktojë organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
  - q) të miratojë marrëveshjet e lidhura në kushtet e konflikteve të interesit, në përputhje me nenin



13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;

- r) të miratojë borxhe ose dhënien e garancive financiare;
- s) të vendosë për cdo çështje tjetër e cila bie brenda kompetencave të ortakut të vetëm/ortakëve të Shoqërisë/ nga ligji dhe/ose ky Statut.

### Neni 13

#### Administrimi dhe përfaqësimi ligjor

##### Administrimi

- 13.1. Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do t'i caktohet 4 (katër) Administratorëve të cilët emërrohen dhe zëvendësohen nga Ortaku i Vetëm. Administratorët do të kenë kompetenca të përbashkëta mes tyre dhe të drejta lidhur me menaxhimin e Shoqërisë me përjashtim të rasteve kur kohë pas kohe vendoset ndryshe me një vendim të Ortakut të Vetëm. Administratori i Shoqërisë mëmë nuk mund të emërohet si administrator i Shoqërisë bijë ose anasjelltas.
- 13.2. Administratorët kanë kompetenca të plota për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe gëzojnë të drejtën për miratimin e të gjitha vendimeve që mund t'i duken të përshtatshme për të realizuar dhe ushtruar objektin e Shoqërisë, me përjashtim të veprimeve që sipas ligjit, këtij Statuti apo vendimeve të herëpashershme Ortakut të Vetëm, bëjnë pjesë në kompetencat e një subjekti tjetër.
- 13.3. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në zëvendësimin e tyre në përputhje me nenin 13.1 më sipër, për një mandat maksimal prej 5 vitesh; mandat ky i rinovueshëm. Në realizimin e detyrës së tyre, Administratorët do të tregojnë kujdesin e një personi të besueshëm dhe të përgjegjshëm të anagazhuar në biznes dhe duhet të ruajnë sekretin lidhur me çështje konfidenciale.
- 13.4. Administratorët e parë të Shoqërisë, të emëruar për një periudhë fillestare dy vjecare janë:
  - **Znj. DÓRA DEBRECZENI**, shtetase e Magyar/Hungari, mbajtëse e pasaportës me nr. BD3091839;
  - **Z. CEVDET YAPICI**, shtetas turk, mbajtës i pasaportës nr. U 14611527;
  - **Znj. ADRIENNE DR. BENEDEK**, shtetase e Magyar/ Hungari, mbajtëse e pasaportës me nr. BD7983520;
  - **Znj. ANILA ÇELIKU**, shtetase shqiptare, me nr. personal të dokumentit të identifikimit H05923036V.

##### Përfaqësimi Ligjor

- 13.5. Si rregull i përgjithshëm, Administratorët janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë dhe të ndër marrin aktivitete biznesi të Shoqërisë vetëm bashkërisht, në grup prej dy personash. Ndaj, në lidhje me palë të treta dhe autoritete publike, Shoqëria përfaqësohet përmes cdo grupimi prej dy administratorësh të Shoqërisë, rast në të cilin nënshkrimi i dy prej administratorëve të Shoqërisë do të konsiderohet i mjaftueshëm. Nënshkrimi në emër të Shoqërisë ka fuqi ligjore kur personat e



autorizuar për të nënshkruar në emër të Shoqërisë vendosin firmën e tyre, nën apo mbi emrin e shtypur, të shkruar, stampuar ose printuar të Shoqërisë.

- 13.6. Si përjashtim nga rregulli i parashikuar në nenin 13.5, **Znj. Anila Celiku** është e autorizuar për të përfaqësuar Shoqërinë individualisht për hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë pranë bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, në monedhën EUR/Euro; USD/ Dollarë ose Lekë/ALL, si dhe për autorizimin e palëve të treta si për shembull konsulentëve të jashtëm, për çështje që lidhen me regjistrimin e Shoqërisë pranë strukturave përkatëse publike në Shqipëri.
- 13.7. Si përjashtim i dytë nga rregulli i parashikuar në nenin 13.5, Administratorët e Shoqërisë mund të autorizojnë unanimisht secilin prej Administratorëve të Shoqërisë për të përfaqësuar Shoqërinë individualisht për transaksione, veprime apo operacione biznesi të caktuara, përmes një prokure e cila mban nënshkrimet e të gjithë Administratorëve të Shoqërisë dhe vulën e saj, me përjashtim të rastit kur noterizimi i prokurës kërkohet në mënyrë të detyrueshme nga ligji.
- 13.8. Per transaksionet e listuara më poshtë, do të nevojitet gjithashtu edhe miratimi i Ortakut të Vetëm:
- a) ndryshime të qëndrueshme/afatgjata të administrimit, organizimit, prodhimit ose shpërndarjes;
  - b) blerje, disponim ose barrësimi i pasurive të paluajtshme;
  - c) cdo transaksion me risk të lartë apo donacione;
  - d) blerjen ose shfrytëzimin e patentave, të drejtave të emrit tregtar dhe licensave të cdo lloji;
  - e) negociimi ose heqja dorë nga çfarëdo pretendimi i Shoqërisë;
  - f) dhënien e garancive, sigurimeve, barrëve ose mjeteve të tjera të garancisë në favor të të tretëve.

#### **Neni 14**

##### **E drejta për të deleguar**

- 14.1. Administratorët kanë të drejtë të delegojnë të drejtat e tyre (ne grup prej dy administratorësh), përmes një prokure, tërësisht ose pjesërisht tek një person i tretë, përfshirë punonjës të tjerë të Shoqërisë, brenda kompetencave të tyre si parashikohen në këtë Statut.

#### **Neni 15**

##### **Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia**

- 15.1. Në vazhdim të detyrimeve të përcaktuara në Nenet 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori duhet të:
- a. Të zbatojë detyrat e përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në këtë Statut me mirëbesim dhe në interesin e Shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vëmendje të vecantë impaktit që ka aktiviteti i shoqërisë në mjedis;
  - b. Të ushtrojë kompetencat e tij në përputhje me të drejtat që i jepen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe ky Statut vetëm për qëllimet e përcaktuara këtu;
  - c. T'i kushtojë vëmendjen e duhur çështjeve për të cilat duhet të marrë vendim;



- d. Të shmang cdo konflikt aktual dhe të mundshëm ndërmjet interesave të tij personale dhe atyre të Shoqërisë
- e. Të ushtrojë funksionet e tij me kujdesin dhe vëmendjen e duhur;
- f. Të verë në dispozicion cdo të dhënë ekonomike ose të lidhur me biznesin, kërkuar nga Ortaku i Vetëm, brenda një kohe të arsyeshme dhe në cdo rast jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuara.

#### **Neni 16**

#### **Eksperti/ët Kontabël i/të Miratuar**

- 16.1. Eksperti/ët Kontabël i /të jashtëm do të caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm nëse është e nevojshme. Mandati i auditorit, nëse caktohet një i tillë, duhet të rinovohet cdo vit.

#### **Neni 17**

#### **Viti Financiar**

- 17.1. Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, që fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të secilit vit.

#### **Neni 18**

#### **Bilanci. Kontabiliteti**

- 18.1. Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet dhe t'i paraqitet organeve tatimore përpara fundit të Marsit të vitit pasues.
- 18.2. Librat kontabël duhet të mbahen në gjuhën Shqipe dhe me vlera të përcaktuara në monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të ndara në monedhë të huaj, vlerat e të cilave do të konvertohen çdo muaj në monedhën vendase.
- 18.3. Shoqëria mund të marrë financime nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim, Shoqëria mund të vendosë si garanci kuotat e saj, ose mund të vendosë të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 19**

#### **Likuidimi**

- 19.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë prishjen e Shoqërisë.
- 19.2. Me vendim të Ortakut të Vetëm do të emërohet një likuidator ose një grup likuidatorësh, të cilët do të jene përgjegjës për të kryer procedurat e likuidimit.
- 19.3. Likuidatori/Likuidatorët do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban gjëndjen ekonomike të përgjithshme të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për kryerjen e tij. Në fund të këtij procesi, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë mbylljen



e procedurës së likuidimit.

**Neni 20**  
**Ndryshimet në Statut**

20.1. Dispozitat e këtij Statuti mund të modifikohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me parashikimet e legjislacionit tregtar.


**Neni 21**  
**Dispozita Përfundimtare**

21.1. Ky Statut është përgatitur dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Angleze dhe do të përkthehet në gjuhën Shqipe. Në rast se ka mospërputhje midis këtyre dy versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën Anlgeze.

Nënshkruar më **21 Janar 2021** nga:

**ORTAKU I VETËM**  
**Vodafone International Holdings B.V**

*Përfaqësuar nga:*  
Anisa Rrumbullaku

  
Anisa Rrumbullaku